Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi

DREJTORIA E ARSIMIT

Në bazë të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës neni 5 pika c, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës neni 35, Ligji i Punës së Republikës së Kosovës neni 8, Drejtoria e Arsimit në Gjilan, shpallë këtë :

K O N K U R S
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS
NË KOHË CAKTUAR

I. Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta

1. **Shkolla Fillore "Abdullah Tahiri" në fsh. Malishevë**
- Dy mësimdhënës të ciklit klasor
2. **Shkolla Fillore "Selami Hallaqi" në Gjilan**
- Një mësimdhënës i ciklit klasor. Kontrata e punës deri më 31.07.2018, pushim pa pagesë.
3. **Shkolla Fillore "Bajram Curri" në fsh. Shurdhan**
- Një mësimdhënës i ciklit klasor. Kontrata e punës deri më 31.05.2018, zëvendësim - pushim i lehonisë.
4. **Shkolla Fillore " Zija Shemsiu" në Gjilan**
- Një mësimdhënës i lëndës së edukatës fizike. Kontrata e punës deri më 31.05.2018, zëvendësim-pushim i lehonisë.
5. **Shkolla Fillore " Agim Ramadani" në fsh. Zhegër**
- Dy mësimdhënës të ciklit klasor.
- Një mësimdhënës i lëndës së gjuhës gjermane, orët mësimore janë të shpërndara si vijon : 5 orë në sh.f. "Agim Ramadani", 2 orë në sh.f. "Ibrahim Uruqi", 2 orë në sh.f. "Vatra e Diturisë" , 2 orë në sh.f. "Dëshmoret e Kombit", 1 orë në sh.f." Vesel Muja" dhe 1 orë në sh.f. "Bajram Curri".
6. **Shkolla Fillore "Dëshmorët e Kombit" në fsh. Livoq i Ulët**
- Një mësimdhënës i lëndës së biologjisë
- Një mësimdhënës i ciklit klasor
7. **Shkolla Fillore "Vatra e Diturisë" në fsh. Livoq i Epërm**
- Një edukatore
- Një mësimdhënës i lëndës së gjeografisë, 13 orë. Kontrata e punës në kohë të caktuar deri më 30.10.2021.
8. **Shkolla Fillore "Skënderbeu" në fsh. Përlepnicë**
- Një mësimdhënës i ciklit klasor. Kontrata e punës deri më 30.06.2018, zëvendësim-pushim i lehonisë.
9. **Shkolla Fillore "Ibrahim Uruqi " në fsh. Bresalc**
- Një mësimdhënës i ciklit klasor
- Një mësimdhënës i ciklit klasor. Kontrata e punës deri më 30.06.2018 zëvendësim-pushim i lehonisë.

10. Shkolla Fillore "Nazim Hikmet" në fsh. Dobërqan

- Një mësimdhënës i lëndës së kulturës muzikore. Kontrata e punës deri më 31.08.2018, pushim pa pagesë.

11. Shkolla Fillore e Muzikës

- Një mësimdhënës të lëndës solokëndim , 10 orë.
- Një mësimdhënës i lëndës së pianos, 10 orë. Kontrata e punës deri më 02.05.2018, pushim i lehonisë.
- Një mësimdhënës i lëndës harpë, 10 orë. Kontrata e punës deri më 02.05.2018, pushim i lehonisë.

12. Shkolla Fillore "Nazmi Hoxha" në Gjilan

- Një mësimdhënës i lëndës së gjeografisë

13 Shkolla Fillore "Thimi Mitko" në Gjilan

- Një mësimdhënës i lëndës së biologjisë, 10 orë.

14 Shkolla Fillore "Musa Zajmi" në Gjilan

- Një mësimdhënës të lëndës së kulturës muzikore , kontrata e punës deri më 30.06.2018, zëvendësim-pushim i lehonisë.
- Një mësimdhënës i lëndës së tik-ut në mësim në gjuhën turke. Kontrata e punës deri më 31.05.2018, zëvendësim-pushim i lehonisë.

<u>II. Shkollat e Mesme të Larta</u>

1. Shkolla e Mesme Gjimnazi Shoqëror "Zenel Hajdini" në Gjilan

- Një mësimdhënës i lëndës së filozofisë. Kontrata e punës deri më 31.08.2018.

2. **Shkolla e Mesme e Mjekësisë " Asllan Elezi" në Gjilan**

- Dy mësimdhënës të lëndëve mjekësore, njëri me 15 orë dhe njëri 10 orë.

3. **Shkolla e Mesme e Artit Pamor "Adem Kastrati" në Gjilan**

- Një mësimdhënës i lëndës së pikturës. Kontrata e punës deri më 31.05.2018, zëvendësim-pushim i lehonisë.

4. **Shkolla e Mesme Ekonomike "Marin Barleti" në Gjilan**

- Një mësimdhënës i lëndës së sociologjisë, 7 orë me plotësim norme 8 orë në Gjimnazin Shoqëror"Zenel Hajdini". 8 orët mësimore janë në kohë të caktuar deri më 31.08.2018.

Kontratat e punës (përveç rasteve të pushimeve të lehonisë dhe atyre të përcaktuara) lëshohen deri më 31.08.2018. Pas skadimit të këtyre kontratave për këto vende të punës, Drejtoria Komunale e Arsimit në cilësinë e punëdhënësit do të bëjë një analizë të tepricave të mësimdhënësve që mund të ketë për vitin shkollor 2018/2019, në të gjitha Shkollat e Komunës së Gjilanit, në rast se nuk paraqiten teprica të mësimdhënësve në të gjitha Shkollat, mësimdhënësve të pranuar do t'iu vazhdohet kontrata e punës në ato shkolla.

<u>Kushtet e konkursit</u> :

Kualifikimi për mësimdhënës : kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativet të MASHT-it në fuqi. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këto vende të punës, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ të MASHT-it,, nr. 8/2010,në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

<u>Për vendet e punës në fjalë nevojiten këto dokumente</u>: diploma mbi përgatitjen profesionale, kopja e letërnjoftimit, vërtetim mbi përvojën e punës, certifikatën e lëshuar nga sektori gjendjes civile me të cilin dëshmohet vendbanimi i kandidatit, vërtetimi nga gjykata kompetente se personi nuk është nën hetime. Të gjitha duhen të jenë kopje dhe nuk kthehen.

Për këto vende të punës, kandidatët do t'i nënshtrohen intervistës me gojë.

Komisioni do të bëjë selektim të aplikacioneve dhe në intervistë ftohen vetëm ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit dhe në pajtim me normativet e MASHT-it në fuqi.

Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga shpallja në gazeta zyrtare dhe në mjetet e tjera të informimit
Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrën për Shërbim të Qytetarëve në Gjilan.
Sqarim : kandidatët të cilët aplikojnë më shumë se një shkollë, mund të aplikojnë vetëm me një formularë të aplikimit duke i cekur emrat e shkollave ku aplikon.
Për kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistave, kandidatët do të informohen përmes njoftimit i cili do të publikohet në tabelat e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në objektin pranë Qendrës për Shërbim me Qytetarë, menjëherë pas mbylljes së konkursit.